



## PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e DISKUTIMIT PUBLIK

Për

### Qarkoren-Buxhetore 2023/01 – Granti për Shëndetësi

Diskutimi publik i mbajtur me dt. **14.06.2022( e marte) në ora 13:00**

Vendi : Salla e Kuvendit në objektin e Komunës.

Diskutimin Publik u organizua nga Kuvendi i Komunës së Deçanit përmes grupit punues në përbërje : 1.Lulavere Selmanaj (AAK), 2.Shkodran Mustafaj (AAK), 3.Lendita Berisha (AAK) 4.Sylë Balaj (LDK), 5.Teuta Neziraj (LVV), ndërsa takimin e udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Ky diskutim publik ka qenë i hapur për të gjithë qytetarët e komunës së Deçanit, shoqërinë civile, gazetarët etj.

Në takim kanë marrë pjesë gjithsejt 30 pjesëmarrës ( 19 meshkuj dhe 11 femra), Drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj, Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, znj.Agnesa Vokshi, staf mjekësorë dhe qytetarë.

Drejtoresha e Buxhetit, znj.Dafina Cacaj, sqaron rreth Qarkores së parë buxhetore, sqarime ka dhënë edhe Drejtoresha e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, znj.Agnesa Vokshi.

Gjatë debatit u dhanë mendime dhe ide të ndryshme për funksionim efikas të fushës së shëndetësisë, por gjatë debatit të zhvilluar nuk pati propozime konkrete për ndryshime.

Deçan, dt.14.06.2022

Procesmbajtëse:  
Dyke Lolluni

